

Çertifikata e peshimit të bananes procedura

Për qëllim të nenit 182, pesha neto e secilës dërgesë së bananeve të freskëta duhet të përcaktohet nga peshuesit e autorizuar në çdo vend të shkarkimit në përputhje me procedure e përcaktuar më poshtë.

Për qëllime të këtij aneksi dhe të nenit 182, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) ‘pesha neto e bananeve të freskëta’ do të thotë pesha e vetë bananeve pa materialin paketues dhe konteinerët paketues të çdo lloji;
 - (b) ‘dërgesë e bananeve të freskëta’ do të thotë dergesa që përfshin sasinë totale të bananeve të freskëta të ngarkuara në një mjet të vetëm transporti dhe të dërguara nga një eksportues i vetëm tek një ose më shumë marrës ngarkesash;
 - (c) ‘vend i shkarkimit’ do të thotë çdo vend ku një ngarkesë e bananeve të freskëta mund të shkarkohet ose të lëvizë nën një regjim doganor, ose në rastin e transportit me konteiner, ku konteineri është shkarkuar nga anija, ose mjete fluturues, ose mjete të tjera kryesore të transportit ose atje ku konteineri zbrazet.
1. Një kampion i njësive të bananeve të paketuara duhet të përzgjidhet për çdo tip të paketimit dhe për çdo origjinë. Kampioni i njësive të bananeve të paketuara për t’u peshuar duhet të përbëjë një kampion përfaqësues të dërgesës së bananeve të freskëta. Kjo njësi duhet të përmbajë të paktë sasi të treguara më poshtë:

Numri i njësive të bananeve të paketuara (sipas tipit të paketimit dhe origjinës)	Numri i njësive të bananeve të paketuara për t’u inspektuar
— deri në 400	3
— nga 401 deri në 700	4
— nga 701 deri në 1 100	6
— nga 1 101 deri në 2 200	8
— nga 2 201 deri në 4 400	10
— nga 4 401 deri në 6 600	12
— më shumë se 6 600	14

2. Pesha neto duhet të përcaktohet si më poshtë:

- (a) Duke peshuar secilën njësi të bananeve të paketuara që inspektohet (pesha bruto);
- (b) Duke hapur të paktën një njësi të bananeve të paketuara, për të llogaritur peshën e paketimit;
- (c) Pesha e këtij paketimi duhet të pranohet për të gjitha paketimet e të njëtit tip dhe origjinë dhe duhet të zbritet nga pesha e të gjithë njësive të bananeve të peshuara;
- (d) Pesha neto mesatare për njësi të bananeve të paketuara e përcaktuar në këtë mënyrë për secilin tip dhe origjinë, bazuar nga pesha e kampionëve të kontrolluar, duhet të pranohet si bazë për përcaktimin e peshës neto të dërgesës së bananeve të

freskëta.

3. Nëse autoriteti doganor nuk kontrollon njëkohësisht certifikatat e peshimit të bananes, pesha neto e deklaruar në të tilla certifikata duhet të jenë të pranueshme për autoritet doganore me kusht që diferenca të mos jetë më shumë ose më pak se 1 % midis peshës neto të deklaruar dhe peshës neto mesatare të vendosur nga autoritetet doganore.
4. Certifikata e peshimit të bananes duhet t'i paraqitet zyrës doganore në të cilën do të depozitohet deklarata për çlirim për qarkullim të lirë. Autoritet doganore duhet të zbatojnë rezultatin e kampionit të treguar në certifikatën e peshimit të bananes për të gjithë dërgesën e bananave të freskëta me të cilën ka lidhje kjo certifikatë.
